



BASHKIA KAMËZ



Plani Arsimit Parauniversitar 2026 - 2028

Përmbajtja

1. Hyrje dhe konteksti.....	6
Konteksti administrativ	6
Të dhëna demografike	6
1. Njësia Administrative Kamëz.....	6
2. Njësia Administrative Paskuqan.....	7
Kudri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor	8
2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025.....	9
Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor.....	9
Vendndodhja dhe klasifikimi	9
Frekuentimi në kopshte	9
Energjia dhe shërbimet teknologjike	10
Kushtet higjieno-sanitare dhe ushqimi	11
Rekomandime	12
3. Analiza e shërbimit të në shkolla bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025	12
Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit.....	12
Frekuentimi në arsimin fillor.....	14
Frekuentimi arsimit 9-vjecar	14
Frekuentimi arsimit i mesëm.....	14
4. Analiza edhe shpërndarja e stafit arsimor në territorin e bashkisë	17
Shkolla	17
Kopshte	18
5. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative	19
Njësia Administrative: Paskuqan	19
Njësia Administrative: Lagja Bathore	21
Njësia Administrative: Lagja Nr. 1	21
Njësia Administrative: Lagja nr.2	22
6. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar	23
Shtyllat udhëheqëse të vizionit:	24
Përmbledhje e Qëllimeve, Objektiveve dhe Aktiviteteve	24
7. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar	26
Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar	26
8. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)	30
9. Plani i investimeve kapitale	42
10. Monitorimi dhe vlerësimi	43

Indikatorët e Performancës.....	43
Planifikimi i vlerësimit të progresit.....	43
Përfshirja e aktorëve të jashtëm	43
Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi.....	43
Monitorimi i realizimit të aktiviteteve	43
Vlerësimi i ndikimit në komunitet	44
11. Rishikimi dhe përshtatja e planit.....	44
Procesi i rishikimit	44
Përshtatja e masave dhe aktiviteteve	45
12. Raportimi dhe transparenca	45
13. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar	46
14. Aneks 2: Lista e shkollave	47
15. Aneks 2: Lista e kopshteve	48

Parathënie nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli

Të dashur qytetarë,

Të nderuar prindër dhe të gjithë bashkëpunëtorët tanë në rritjen dhe edukimin e brezit të ri,

Në Bashkinë e Kamzës, fëmijët janë në qendër të çdo vizioni tonë për të ardhmen. Qyteti ynë është një komunitet i gjallë, me rini të shumtë dhe energji të pashtershme – një potencial i jashtëzakonshëm që kërkon mbështetje, kujdes dhe mundësi të barabarta për zhvillim. Arsimi parauniversitar nuk është thjesht një detyrim institucional; është angazhim i përditshëm dhe investim strategjik për të ardhmen e Kamzës.

Të dhënat flasin qartë: mbi 70 % e fëmijëve 3–6 vjeç ndjekin kopshtin, por disa prej tyre përballen me barriera infrastrukturore, ekonomike dhe kulturore. Është detyra jonë t'i adresojmë këto sfida me vendosmëri e planifikim afatgjatë.

Ky dokument, *Plani i Arsimit Parauniversitar 2026–2028*, udhëheq vizionin tonë:

“Të ndërtojmë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, cilësor dhe të aksesueshëm për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Kamëz – ku çdo institucion edukativ të jetë një hapësirë e sigurt, e pajisur, e përkushtuar dhe e lidhur ngushtë me komunitetin.”

Ky plan është më shumë se një dokument – është reflektim i situatës arsimore dhe udhërrëfyes për transformim. Ai përfshin tre fusha prioritare:

1. **Siguria dhe mjedisi i përshtatshëm** – Bashkia Kamëz ka përmirësuar rrënjësisht infrastrukturën arsimore, duke finalizuar 18 objekte dhe duke ndërtuar shumë të tjera me standarde bashkëkohore
2. **Cilësia e edukimit** – Mësuesit dhe drejtuesit institucionalë janë vlerësuar publikisht për përkushtimin e tyre, kontribues kyç në suksesin e nxënësve.
3. **Bashkëpunimi me komunitetin** – Përmes dëgjësive publike të Buxhetit Afatmesëm 2026–2028, qytetarët kanë ndikuar drejtpërdrejt në hartimin e planit të investimeve për arsimin

Synimi ynë është i qartë: çdo fëmijë të ketë akses në arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe me mundësi reale. Nuk është thjesht ndërtim i shkollave dhe kopshteve – por ndërtim besimi, mundësish dhe një e ardhme me shpresë.

Faleminderit të gjithë atyre që e bëjnë këtë rrugëtim të mundur: mësuesve, prindërve, drejtuesve institucionalë dhe, mbi të gjitha, fëmijëve.

Së bashku, po ndërtojmë një Kamëz ku arsimi është themel, dritare dhe çelës për zhvillim të qëndrueshëm.

Rakip Suli

Kryetar i Bashkisë Kamëz

Falënderime

Bashkia Kamëz shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Kamzës, për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për angazhimin e strukturave të tij në sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.

Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioritetëve të komunitetit.

Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Kamëz..

1. Hyrje dhe konteksti

Konteksti administrativ

Bashkia Kamëz përfshin një numër njësish administrative, secila prej të cilave luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin lokal, përfshirë edhe shërbimet e arsimit parashkollor.

Kjo strukturë e përbërë nga 4 njësi administrative përbëhet nga një ndërthurje e zonave urbane dhe rurale, çka ndikon ndjeshëm në mënyrën e organizimit të shërbimeve publike, si dhe në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukture dhe financiare.

Prania e diversitetit demografik mes njërive administrative kërkon një qasje të diferencuar në planifikimin dhe ofrimin e arsimit parashkollor, për të garantuar akses të barabartë dhe cilësi të njëtrajtshme të shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë.

Aktualisht, Bashkia Kamëz përfshin gjithsej 4 njësi administrative:

- Paskuqan
- Lagjja Bathore
- Lagjja Nr.1
- Lagjja Nr.2

të cilat përbëjnë bazën e ofrimit të shërbimeve publike, përfshirë arasimin parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.

Të dhëna administrative	Vlerë
Sipërfaqja	37.18 km ²
Popullsia e Bashkisë	96,137 (Cens 2023)
Popullsi Kamëz	61,739 (Cens 2023)
Popullsi Paskuqan	34,398 (Cens 2023)
Njësi administrative	4: Paskuqan, Lagjja Bathore, Lagjja Nr.10, Lagjja Nr.2
Fshatra të përfshira	14 fshatra përmes njërive

Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Kamëz është 96,137 banorë. Të dy njësitë kanë një strukturë moshore të ngjashme, me dominim të popullsisë në moshë aktive (rreth 67%). Paskuqani ka një përqindje më të lartë të fëmijëve se Kamza, çka mund të sinjalizojë një nevojë të shtuar për shërbime arsimore dhe çerdhe/kopshte. Struktura gjinore është mjaft e balancuar në të dy njësitë, me një mbizotërim të lehtë të femrave.

1. Njësia Administrative Kamëz

Popullsia totale e Kamzës është **61,739 banorë**.

- **Fëmijët dhe të rinjtë (0–14 vjeç)** përbëjnë **19.42%** të popullsisë (11,992 banorë), një tregues i pranishmërisë së lartë të moshave të reja.
- **Grupi i moshës aktive (15–64 vjeç)** përbën **67.64%** të popullsisë (41,758 banorë), duke treguar një bazë të fortë pune dhe kontribut ekonomik.
- **Të moshuarit (65+ vjeç)** përfaqësojnë **12.94%** të popullsisë (7,989 banorë), një përqindje e konsiderueshme që kërkon vëmendje në shërbime sociale dhe shëndetësore.
- **Meshkujt** përbëjnë **49.32%** të popullsisë (30,448 banorë), ndërsa **femrat** janë pak më të shumta, me **50.68%** (31,291 banorë).

2. Njësia Administrative Paskuqan

Popullsia totale e Paskuqanit është **34,398 banorë**.

- **Fëmijët dhe të rinjtë (0–14 vjeç)** përbëjnë **20.82%** të popullsisë (7,163 banorë), një përqindje pak më e lartë se ajo në Kamëz.
- **Grupi i moshës aktive (15–64 vjeç)** përfaqëson **67.20%** të popullsisë (23,117 banorë), e cila është e ngjashme me strukturën e Kamzës.
- **Të moshuarit (65+ vjeç)** janë **11.97%** e popullsisë (4,118 banorë), një nivel pak më i ulët krahasuar me Kamzën.
- **Meshkujt** zënë **49.49%** të popullsisë (17,023 banorë), ndërsa **femrat** përbëjnë **50.51%** (17,375 banorë).

Kjo përbërje demografike tregon nevojën për një planifikim të kujdesshëm të burimeve arsimore, duke marrë parasysh kërkesën e lartë për shërbime edukimi, veçanërisht në fazat e hershme të zhvillimit të fëmijëve dhe në arsimin e mesëm.

Gjinia	Grup-mosha	Popullsia banuese BASHKIA KAMËZ	Popullsia banuese Kamëz	Popullsia banuese Paskuqan
Gjithsej	Gjithsej	96137	61739	34398
	0-14	19155	11992	7163
	15-64	64875	41758	23117
	65+	12107	7989	4118
Meshkuj	Gjithsej	47471	30448	17023
	0-14	10026	6238	3788
	15-64	31658	20405	11253
	65+	5787	3805	1982
Femra	Gjithsej	48666	31291	17375
	0-14	9129	5754	3375
	15-64	33217	21353	11864
	65+	6320	4184	2136

Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor

Zbatimi i funksioneve të Bashkisë Kamëz në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe politik, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike për garantimin e të drejtës për arsim.

Bazën më të lartë ligjore e përbën **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, ku në nenin 57, pika 1, sanksionohet e drejta për arsim për të gjithë qytetarët. Kjo e drejtë konkretizohet më tej përmes **Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”**, të ndryshuar me **Ligjin nr. 48/2018**, i cili përcakton strukturën dhe funksionimin e arsimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe profesional. Ky ligj rregullon gjithashtu standardet e cilësisë, përfshirjes, vlerësimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” u njeh bashkive kompetenca të plota për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike, si dhe role mbështetëse në arsimin bazë dhe të mesëm, përmes sigurimit të infrastrukturës, përfshirjes sociale dhe koordinimit me institucionet qendrore. Këto funksione financohen dhe mbështeten në përputhje me **Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**, dhe **Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”**, të cilët përcaktojnë rregullat e menaxhimit financiar në nivel vendor. Po ashtu, **Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”**, i ndryshuar, shërben si mjet për mobilizimin e të ardhurave që bashkia mund të përdorë për të mbështetur sektorin e arsimit.

Në nivel zbatimi, funksionimi i institucioneve arsimore rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore. Ndër më të rëndësishmet është **Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020**, që miraton rregulloren e përgjithshme për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, si dhe **Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023**, që përcakton normat për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore për mësuesit. Po ashtu, **udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, specifikon organizimin e vitit shkollor 2024–2025, ndërsa **Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018**, përcakton ngritjen dhe funksionimin e bordeve të institucioneve arsimore, si mekanizma pjesëmarrjeje dhe monitorimi. Një dokument me rëndësi për cilësinë e arsimit parashkollor është edhe **Urdhri nr. 199, datë 07.05.2024**, që miraton Kornizën e vlerësimit të cilësisë së kopshteve.

Në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Bashkia Kamëz udhëhiqet gjithashtu nga **Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”** dhe **Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”**, të cilët kërkojnë ndërhyrje të koordinuara për mbështetjen e fëmijëve në nevojë dhe parandalimin e përjashtimit social. Në këtë drejtim, udhëzime specifike si **Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014**, për rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët romë, dhe **Plani Kombëtar i Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025**, përbëjnë udhërrëfyes për politikat lokale në territorin e Bashkisë Kamëz.

Një fushë me rëndësi të veçantë është edhe ofrimi i **shërbimit psiko-social në shkolla**, i cili rregullohet me **Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020**, si dhe me **udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor**, të hartuar për stafet e bashkive dhe të zyrave vendore arsimore. Gjithashtu, për të garantuar një ambient të sigurt dixhital për fëmijët, zbatohet **Udhëzimi i përbashkët MAS-MShMS nr. 658, datë 23.09.2019**, i cili përcakton masa për mbrojtjen e tyre nga përmbajtjet e dëmshme në internet.


Nëpërmjet këtij kuadri të gjerë ligjor dhe politik, Bashkia Kamëz vepron si një aktor kyç në zbatimin e politikave arsimore dhe sociale, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve në territorin e saj. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me Zyrën

Vendore Arsimore dhe institucionet e tjera publike, synohet ndërtimi i një sistemi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë.

2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor

Në Bashkinë Kamëz shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Kamzë funksionojnë 20 kopshte të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.



Njesia Administrative	Numri i Kopshteve
Lagjja Bathore	5
Lagjja nr.1	5
Lagjja nr.2	4
Paskuqan	6

Vendndodhja dhe klasifikimi

Të gjitha kopshtet e përfshira ndodhen në lagje të ndryshme të Kamzës, me pjesën më të madhe të tyre të klasifikuara si **“qendër”** dhe disa si **“periferi”**. Kjo ndarje ndihmon në analizimin e aksesit dhe përhapjes gjeografike të shërbimit parashkollor.

Frekuentimi në kopshte

Në bashkinë Kamëz, sipas të dhënave më të fundit, numri total i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç është 5552, prej të cilët 3044 janë djem dhe 2508 janë vajza. Nga kjo popullsi, 3918 fëmijë ndjekin institucionet parashkollore (kopshtin), konkretisht 2170 djem dhe 1748 vajza.


Kjo përfaqëson një përqindje të përgjithshme prej 70.57% të fëmijëve që janë të përfshirë në arsimimin parashkollor. Pavarësisht angazhimit të vazhdueshëm të Bashkisë për rritjen e përfshirjes

në edukimin parashkollor 1634 fëmijë ende nuk ndjekin kopshtin nga të cilët 874 janë djem dhe 760 janë vajza.

Kjo mungesë lidhet kryesisht me arsye të justifikueshme si migrimi i përkohshëm i familjeve për arsye pune, emigracioni, gjendja shëndetësore apo trajtimet zhvëllimore të fëmijës, kujdesi në kushte shtëpiake.

Bashkia është duke analizuar këto faktorë me qëllim që të ndërmarrë masa të përshtatshme dhe të ofrojë mbështetje të synuar për familjet, në funksion të rritjes graduale të përfshirjes në vitet në vijim.

Grafiku më poshtë paraqet numrin e fëmijëve që ndjekin dhe nuk ndjekin kopshtet publike, sipas grupit total, djemve dhe vajzave.



Energjia dhe shërbimet teknologjike

Bashkia Kamëz përfaqëson një standard bashkëkohor dhe tërësisht të përputhshëm me kërkesat e edukimit parashkollor modern dhe European. Të gjitha institucionet parashkollore (20 njezet) janë të pajisura me një rrjet të qëndrueshëm dhe të sigurt energjie elektrike, të instaluar sipas normave teknike europiane.

Sistemet elektrike janë të mirëstrukturuara, me ndriçim efikas dhe ambiente të përshtatura për zhvillimin e fëmijëve në kushte komoditeti dhe sigurie maksimale. Kopshtet me ushqim jan

Në aspektin teknologjik, kopshtet ofrojnë mjedise të pasura me pajisje moderne mësimore, duke përfshirë ekranë, pajisje multimediale dhe akses të garantuar në rrjetin e internetit. Përdorimi i teknologjisë është integruar në mënyrë të natyrshme në aktivitetet edukative, duke krijuar një mjedis nxitës, tërheqës dhe në përputhje me qasjet më të reja pedagogjike.

Bashkia Kamëz ka investuar në rritjen e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve në kopshtet publike, përmes pajisjes së tyre me kamera sigurie. Gjithashtu, janë ngritur salla të posaçme monitorimi në dy qendra kryesore: në Kamëz dhe në Paskuqan, duke mundësuar mbikëqyrje të vazhdueshme dhe reagim të shpejtë në raste nevoje. Në kuadër të politikave të përfshirjes sociale dhe fuqizimit të personave me aftësi ndryshe, në këto struktura janë punësuar **dy vajza me aftësi ndryshe**, duke ofruar jo vetëm mundësi punësimi, por edhe shembuj konkretë të integritit të tyre në jetën sociale dhe institucionale të qytetit.

Kopshtet publike në Kamëz janë të pajisura me kënde bashkëkohore lojërash dhe hapësira të jashtme të sistemuara, që krijojnë një mjedis të sigurt, të gjallë dhe nxitës për zhvillimin fizik, social dhe emocional të fëmijëve. Këto hapësira janë konceptuar për të nxitur lojën aktive dhe ndërveprimin mes fëmijëve, duke e bërë kopshtin jo vetëm një vend mësimi, por edhe një hapësirë të dashur dhe tërheqëse për ta.

Falë këtyre investimeve strategjike, fëmijët në institucionet parashkollore të Kamzës zhvillojnë njohuri, aftësi dhe përvoja të hershme digjitale në një mjedis që reflekton standardet më të avancuara të edukimit në nivel kombëtar dhe europian.

Kushtet higjieno-sanitare dhe ushqimi

Kushtet higjieno-sanitare dhe shërbimi ushqimor në institucionet parashkollore të Bashkisë Kamëz janë në përputhje të plotë me standardet më të avancuara të kujdesit dhe sigurisë për fëmijët. Ambientet e brendshme dhe të jashtme të kopshteve mirëmbahen në mënyrë të rregullt dhe sistematike, me pastrim dhe dezinfektim ditor, duke garantuar higjienë të lartë dhe mjedise të pastra për zhvillimin dhe lojën e fëmijëve.

Tualetet, lavamanët dhe hapësirat sanitare janë ndërtuar sipas parametrave për moshat 3–6 vjeç, me akses të lehtësuar, ventilim të mirë dhe materiale të sigurisë së lartë. Gjithashtu, janë siguruar furnizime të vazhdueshme me ujë të rrjedhshëm dhe produkte higjienike cilësore.

Një nga risitë më të rëndësishme është **funksionimi i kopshteve**, ku **ofrohet ushqim i përgatitur në vend**, sipas standardeve të sigurisë ushqimore dhe të përshtatura për moshat e vogla. Godinat e reja janë **të pajisura me ashensorë**, duke siguruar **akses të lehtësuar për fëmijët me aftësi të kufizuara**, si dhe për staf dhe prindër.

Në kopshtet me ushqim ofrohet menu të balancuara ushqimore (menu e verës dhe menu e dimerit) të hartuara nga specialistë të dietologjisë dhe miratuara nga autoritetet shëndetësore. Ushqimi përgatitet në kushte të kontrolluara higjienike, në kuzhina të pajisura plotësisht dhe të certifikuara, duke garantuar siguri ushqimore dhe vlera të larta ushqyese për fëmijët. Aktualisht **1,200 fëmijë** përfitojnë shërbimin ushqimor ditor dhe fjetje në kopshtet e Bashkisë Kamëz, me një pagesë ditore prej 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

Një element veçanërisht domethënës është fakti që **300 fëmijë përfitojnë shërbimin me ushqim pa pagesë**, në kuadër të mbështetjes sociale të bashkisë për familjet në nevojë. Kjo politikë sociale ndihmon jo vetëm në sigurimin e mirëqenies së fëmijëve, por edhe në rritjen e përfshirjes së tyre në institucionet parashkollore. Ky element përfaqëson një angazhim konkret për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës, të sigurt dhe të përshtatshëm për të gjithë fëmijët.

Shërbimi psiko-social në institucionet parashkollore – Mbështetje gjithëpërfshirëse për zhvillimin e fëmijëve

Në funksion të përmirësimit të cilësisë së kujdesit dhe edukimit në institucionet parashkollore, Bashkia Kamëz ka ngritur në kuadër të Drejtorisë së Arsimit një Sektor të specializuar për shërbimin psiko-social, i cili mbështet dhe koordinon punën në terren në të gjitha kopshtet publike të qytetit.

Ky shërbim funksionon në mënyrë të integruar si pjesë e përhershme e strukturës së kopshtit dhe përfshin:

- Punonjës socialë që ndihmojnë në adresimin e çështjeve familjare dhe sociale që ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve,
- Psikologë, të cilët vlerësojnë dhe mbështesin zhvillimin emocional, sjellor dhe social të fëmijëve,
- Infermierë, që garantojnë monitorimin e vazhdueshëm të shëndetit dhe sigurisë fizike në institucion.

Ky model i integruar i shërbimit psiko-social është një element i rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të sigurt, mbështetës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët në vitet e tyre të para, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e tyre të shëndetshëm dhe përgatitjen për arsimin bazë.

Rekomandime

Analiza tregon se shumica e kopshteve në Bashkinë Kamëz:

- janë të pozicionuara mirë në territor (qendra/lartësia e mbulimit),
- kanë akses në energji, ujë, internet,
- Duhet të verifikohet infrastruktura ndihmëse (rampa, shirita),
- Dixhitalizim i regjistrimit me të dhënat e shërbimit mund të jetë një instrument shumë më i mirë për analizimin dhe planifikimin e shërbimit në kohë, me efikasitet dhe efektivitet

3. Analiza e shërbimit në shkolla bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit

Në territorin e Bashkisë Kamëz janë të shpërndara gjithsej 24 institucione arsimore të niveleve të ndryshme, të cilat mbulojnë të gjitha njësitë administrative urbane dhe rurale të bashkisë. Këto institucione përfaqësojnë një rrjet të gjerë dhe të larmishëm të arsimit parauniversitar.


Ato klasifikohen në disa nivele sipas ciklit të edukimit që ofrojnë, duke përfshirë: shkolla 9-vjeçare (18 gjithsej), shkolla të mesme (5 gjithsej), shkollë e mesme profesionale (1 gjithsej)

Shkollat 9-vjeçare, gjithsej 18 në numër, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.

Shkolla e mesme, në numër 5 shkolla të mesme janë institucione që synojnë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare apo për përgatitje për tregun e punës. Këto shkolla janë të vendosura në zona strategjike për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme të bashkisë.

Shkolla e Mesme Profesionale paraqet një model të zhvillimit të arsimit profesional publik në Shqipëri, me infrastrukturë moderne, oferta praktike dhe akreditime zyrtare. Ajo mbështet orientimin profesional të të rinjve përmes praktikave, bashkëpunimeve institucionale dhe programeve që lidhen ngushtë me tregun e punës. Vlerësohet si një aset strategjik për zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit të Kamzës dhe më gjerë.

Në tërësi, rrjeti arsimor i Bashkisë është konceptuar për të siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve ekonomike.



Bashkia Kamëz ka ndërmarrë një transformim të thellë në infrastrukturën arsimore, duke e kthyer shkollën nga një ndërtesë funksionale në një mjedis zhvillimi gjithëpërfshirës, inovativ dhe të sigurt. Aktualisht, 24 shkolla publike janë të pajisura me kushte super moderne, ku çdo element është menduar për të mbështetur një proces mësimor cilësor dhe bashkëkohor.

Këto shkolla përfshijnë:

- Klasa të rinovuara me mobilim ergonomik dhe ndriçim natyral;
- Sisteme ngrohje dhe ventilimi, që sigurojnë një klimë të përshtatshme gjatë gjithë vitit;
- Salla multifunktionale për aktivitete kulturore, sociale dhe sportive;
- Fusha sportive dhe ambiente të jashtme të sistemuara, që nxisin zhvillimin fizik dhe bashkëpunimin ndërmjet nxënësve;
- Hapësira për nxënësit me aftësi ndryshe, duke përfshirë akses me ashensorë, tualete të dedikuara dhe rrugë të përshtatura hyrëse;
- Sisteme sigurie me kamera dhe monitorim në shkolla të caktuara;
- Kabinete didaktike për lëndë shkencore dhe laboratorë të teknologjisë;
- **“Smart Lab”** në 14 shkolla – laboratorë inteligjentë, ku teknologjia moderne bashkëvepron me mësimdhënien, duke u dhënë nxënësve mundësinë të mësojnë në mënyrë interaktive, krijuese dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Ky standard i ri shkolle nuk është një investim në potencialin dhe të ardhmen e çdo fëmije të Kamzës.

Frekuentimi në arsimin fillor

Gjinia	Numri i Nxënësve	Përqindja (%)
Djem	3266	51.76
Vajza	3044	48.24
Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor	6310	

Në arsimin fillor janë të regjistruar gjithsej 6310, nga të cilët 3266 janë djem dhe 3044 vajza. Sipas të dhënave të raportuara, 51.76% e tyre janë djem dhe 48.24% vajza. Kjo ndarje reflekton situatën e përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi, në varësi të kushteve lokale, demografisë, dhe mundësive të ofruara në komunitet. Të dhënat nënvizojnë rëndësinë e vazhdimet të përpjekjeve për të garantuar akses të

barabartë dhe gjithëpërfshirës në arsimin fillor për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit apo karakteristikave të tjera sociale. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për ndjekjen e shkollës dhe mbështetja institucionale mbeten faktorë kyç për përmirësimin e mëtejshëm të përfshirjes.

Frekuentimi arsimit 9-vjeçar

Në arsimin 9-vjeçar janë të regjistruar gjithsej 6220 nxënës, prej të cilëve 3289 janë djem dhe 2931 vajza. Sipas të dhënave, 52.88% e nxënësve janë djem dhe 47.12% janë vajza. Kjo shpërndarje pasqyron situatën aktuale të përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi dhe ndikohet nga faktorë të ndryshëm lokalë. Pavarësisht variacioneve, këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e monitorimit të rregullt të pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim dhe nevojën për politika që mbështesin vazhdimësinë e shkollimit për të gjithë. Sigurimi i kushteve të favorshme për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar është thelbësor për garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të barabartë për çdo fëmijë.

Gjinia	Numri i Nxënësve	Përqindja (%)
Djem	3289	52.88
Vajza	2931	47.12
Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor	6220	

Frekuentimi arsimit i mesëm

Në arsimin e mesëm janë të regjistruar gjithsej 4390 nxënës, nga të cilët 2456 janë djem dhe 1934

Gjinia	Numri i Nxënësve	Përqindja (%)
Djem	2456	55.95
Vajza	1934	44.05
Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor	4390	

vajza, përkatësisht 55.95% djem dhe 44.05% vajza. Ndarja gjinore në këtë nivel arsimor pasqyron situatën e raportuar për njësinë përkatëse, por këto përqindje mund të jenë të ndryshme në zona të tjera. Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, si dhe

faktorë socialë, ekonomikë apo kulturorë. Kjo e bën të nevojshme që të mbështetet përfshirja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në këtë nivel të rëndësishëm të arsimit.

Frekuentimi arsimit i mesëm profesional

Në arsimin e mesëm profesional janë të regjistruar gjithsej 1536 nxënës, nga të cilët 1215 janë djem

Gjinia	Numri i Nxënësve	Përqindja (%)
Djem	1215	79.41
Vajza	321	20.59
Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor	1536	

dhe 321 vajza, përkatësisht 79.41% djem dhe 20.59% vajza. Kjo shpërndarje reflekton një interes të lartë të të rinjve, veçanërisht të djemve, për profilet teknike dhe praktike që ofrohen nga shkollat profesionale, si teknologjia e informacionit, mekanika, bujqësia dhe shërbimet e transportit.

Megjithatë, është inkurajuese që numri i vajzave që zgjedhin arsimin profesional ka

shënuar rritje graduale vit pas viti, veçanërisht në profile si **shërbimi social-shëndetësor, administrimi i zyrës, dhe hoteleri-turizëm**, të cilat ofrojnë perspektiva të qëndrueshme punësimi.

Ky trend tregon potencialin për zgjerimin e përfshirjes gjinore, veçanërisht nëpërmjet zgjerimit të larmisë së profileve të ofruara dhe rritjes së ndërgjegjësimit mbi mundësitë që arsimi profesional ofron për të dy gjinitë. Përfshirja më e gjerë e vajzave shihet si një prioritet zhvillimor, në përputhje me politikat kombëtare të barazisë dhe zhvillimit gjithëpërfshirës.

Bashkia Kamëz është e angazhuar të nxisë pjesëmarrjen aktive të vajzave në arsimin profesional, përmes promovimit të barazisë gjinore, zgjerimit të orientimit në karrierë që në arsimin bazë, si dhe bashkëpunimit me shkollat, prindërit dhe komunitetin për të thyer gradualisht stereotipet e vjetra dhe për të hapur rrugë të reja për të rinjtë e të rejtat në tregun e punës.

BURSAT

- Bursat e ekselencës

Në kuadër të politikave të saj për nxitjen e cilësisë në arsim dhe mbështetjen e talenteve të reja, Bashkia Kamëz shpërblen me Bursa Ekselence, të dedikuara për nxënësit që shfaqin arritje të larta akademike. Këto bursa synojnë jo vetëm të vlerësojnë dhe motivojnë përpjekjet e nxënësve më të dalluar, por edhe të krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të tyre, pavarësisht sfondit socio-ekonomik.

Përmes këtij instrumenti financiar dhe simbolik, Bashkia forcon rolin e shkollës si vend ku merita, përkushtimi dhe performanca shpërblehen, duke promovuar një kulturë të arsimit cilësor dhe konkurrues në të gjitha nivelet.

Ekselentët e shkollave 9-vjeçare shpërblehen me 27 000 (njëzet e shtatë mijë) lekë/vit

Ekselentët e shkollave të mesme shpërblehen me 45 000 (dyzet e pesë mijë) lekë/vit

- Bursat për arsimin parauniversitar (shkolla 9-vjeçare dhe gjimnaze)

Mbështetur në VKM Nr. 666 10.10.2019 “Për kuotat financiare të shqimit në menca e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave, e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, jepen çdo vit 100 bursa në vlerën 65 880 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë në vit për nxënës.

- Burast për arsimin e mesëm profesional

Mbështetur në VKM Nr. 666 10.10.2019 “Për kuotat financiare të shqimit në menca e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave, e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, jepen çdo vit 600 bursa në vlerën 65 880 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë në vit për nxënës të ndarë sipas kategorive përfituese.

Subvencionimi i transportit për nxënësit – Qasje e barabartë në arsim për të gjithë

Bashkia Kamëz është e angazhuar për të garantuar akses të barabartë në arsim për të gjithë nxënësit, pavarësisht vendbanimit të tyre. Në funksion të këtij qëllimi, është vënë në zbatim skema e subvencionimit të transportit për nxënësit që ndjekin shkollat larg vendbanimit, veçanërisht në zonat periferike dhe rurale të bashkisë.

Kjo masë synon të lehtësojë barrën ekonomike për familjet, të ulë shkallën e mungesave në shkollë dhe të sigurojë një pjesëmarrje të rregullt e dinjitoze në procesin mësimor për të gjithë fëmijët. Përfitues të kësaj skeme janë kryesisht nxënës të ciklit të ulët, të mesëm dhe të lartë që kanë distanca të konsiderueshme midis banesës dhe shkollës përkatëse.

Ky ndërhyrje është pjesë e vizionit të Bashkisë Kamëz për arsim gjithëpërfshirës, të aksesueshëm dhe pa barriera gjeografike apo sociale.

Shkolla si Qendër Komunitare – Një Hapësirë për Edukim dhe Përfshirje Sociale

Shkollat në Kamëz nuk janë vetëm vende ku zhvillohet mësimi formal, por edhe qendra aktive komunitare, ku takohen, bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë nxënës, prindër, mësues dhe aktorë të ndryshëm lokalë. Kjo qasje e integruar promovon një mjedis gjithëpërfshirës dhe mbështetës, ku shkolla shërben si një platformë për organizimin e aktiviteteve kulturore, sportive, sociale dhe edukative për gjithë komunitetin.

Si qendra komunitare, shkollat kontribuojnë në forcimin e lidhjeve sociale, përmirësimin e klimës familjare dhe zhvillimin e vlerave qytetare, duke u kthyer në një faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien e qytetit.

Shkolla Verore “Halit Çoka” – Hapësira e Edukimit dhe Argëtimit Veror për Fëmijët e Kamzës

Shkolla Verore “Halit Çoka” është një nga projektet e Bashkisë Kamëz, që synon të ofrojë për fëmijët një ambient të sigurt, kreativ dhe edukativ gjatë periudhës së pushimeve verore. Në këtë shkollë verore, nxënësit kanë mundësi të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme kulturore, sportive dhe artistike, të kombinuara me mësim ndihmës dhe zhvillim të aftësive të tyre personale.

Kjo iniciativë promovon përfshirjen sociale dhe mbështetjen e familjeve, duke ofruar një alternativë cilësore për kohën e lirë të fëmijëve, si dhe duke kontribuar në zhvillimin e tyre të gjithanshëm në një atmosferë pozitive dhe stimuluese.

Bashkia Kamëz në mbështetje të talenteve të qytetit

Bashkia Kamëz e ka vendosur në fokus të politikave të saj arsimore dhe rinore identifikimin, nxitjen dhe promovimin e talenteve të reja në të gjitha fushat: shkencë, art, kulturë, sport dhe inovacion. Nëpërmjet bashkëpunimit me shkollat, qendrat rinore dhe organizatat partnere, bashkia mbështet aktivitetet që i japin hapësirë dhe zë fëmijëve e të rinjve të talentuar.

Përmes organizimit të konkurseve, ekspozitave, aktiviteteve kulturore e sportive, dhënies së bursave të ekselencës dhe përfshirjes në programe zhvillimi, Bashkia Kamëz synon jo vetëm të zbulojë talentet lokale, por edhe t'i ndihmojë ato të rriten, të përfaqësojnë denjësisht komunitetin dhe të ndërtojnë të ardhmen e tyre mbi mundësitë dhe vlerësimin që meritojnë.

Ky angazhim i përhershëm është dëshmi e besimit të institucionit në kapitalin njerëzor si forca më e madhe për zhvillimin afatgjatë të qytetit.

Ekipet sportive në shkolla – Sporti si pjesë e edukimit gjithëpërfshirës

Bashkia Kamëz i kushton një rëndësi të veçantë sportit në shkolla, duke e konsideruar atë si një komponent thelbësor të zhvillimit të gjithanshëm të nxënësve. Përmes mbështetjes së ekipeve sportive në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, synohet jo vetëm përmirësimi i gjendjes fizike të të rinjve, por edhe edukimi i vlerave si disiplina, bashkëpunimi, respekti dhe loja e ndershme.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, organizohen kampionate të rregullta ndërskollore, ku ekipet sportive shkollore marrin pjesë në disiplina të ndryshme si futboll, volejbol, basketboll dhe atletikë. Këto nisma kanë nxitur masivizimin e pjesëmarrjes së nxënësve dhe kanë krijuar hapësira për identifikimin e talenteve të reja në sport.

Bashkia Kamëz mbështet dhe shpërblen përpjekjet e nxënësve, ku ekipet fituese u vlerësuan me 5,000 lekë për çdo nxënës pjesëmarrës, duke e kthyer sportin në një nxitës real të angazhimit rinor dhe shkollor.

Ky vizion për sportin si pjesë e jetës shkollore synon të ndërtojë breza më të shëndetshëm, më të përgjegjshëm dhe më të lidhur me komunitetin.

4. Analiza edhe shpërndarja e stafit mbështetës për Institucionet Arsimore në territorin e bashkisë

Shkolla

Emri institucionit	Njësia administrative	Punonjës sanitarë	Roje	Punonjës shërbimesh mbështetëse
"Ibrahim Basha"	Bathore	4	1	0
"Halit Coka"	Bathore	8	1	1
"Ahmet Zogu"	Bathore	5	1	1
"Elez Isuf Ndreu"	Bathore	4	0	1 (sekretare)
"Kamzë e re"	Lagjja nr.1	3	1	0
"Niko Hoxha"	Lagjja nr.1	3	1	1
"Demokracia"	Lagjja nr.1	4	1	0
"Nënë Tereza"	Lagjja nr.1	1	1	0
"Dom Nikollë Kaçorri"	Lagjja nr.1	2	1	0
"Hillary Clinton"	Lagjja nr.2	4	1	2
"Fatos Lami"	Lagjja nr.2	3	1	0
"100 Vjetori"	Lagjja nr.2	6	1	0
"Arberia"	Lagjja nr.2	1	1	0
"Ibrahim Rugova"	Lagjja nr.2	5	1	1 (sekretare)
"Sulejman Elezi"	Lagjja nr.2	1	0	1 (sekretare)
"Jashar Hoxha"	Paskuqan	7	1	1
"Azem Hajdari"	Paskuqan	8	1	0
"Lidhja e Prizerenit"	Paskuqan	6	1	0
"Tahir Sinani"	Paskuqan	3	1	0
"Dom Nikollë Kaçorri"	Paskuqan	1	1	0
"Vllazërimi"	Paskuqan	2	1	0
"Isa Boletini"	Paskuqan	4	1	1 (sekretare)
"Gramoz Palushi"	Paskuqan	2	1	1 (sekretare)

Struktura mbështetëse e shkollave në Bashkinë Kamëz përbëhet nga **5 sekretare, 21 roje sigurie, 87 sanitare dhe 6 punonjës të shërbimeve mbështetëse**, të cilët luajnë një rol kyç në funksionimin e përditshëm dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore. Prania e kësaj strukture ndihmon në sigurimin e një mjedisi të pastër, të sigurt dhe të organizuar për nxënësit dhe stafin, duke krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Këta punonjës përfaqësojnë një komponent të rëndësishëm të sistemit arsimor, që garanton cilësi dhe mirëqenie në jetën shkollore të përditshme.

Kopshte

Emri institucionit	Njësia administrative	Edukatorë	Mësuese ndihmëse	Punonjës sanitarë	Roje	Punonjës shërbimesh mbështetëse
Kopshti nr.9 "Bota e Luleve"	Bathore	11	0	7	0	7
Kopshti nr.10 "Lulet e Jetës"	Bathore	14	0	7	1	22
Kopshti nr.11 "Kësulëkuqja"	Bathore	4	0	2	0	0
Kopshti nr.13 "Gjeniu i vogël"	Bathore	5	0	2	0	0
Kopshti nr.20 "Lule Bore"	Bathore	5	0	2	0	0
Kopshti nr.4 "Bletëzat"	Lagjja nr.1	9	0	2	0	8
Kopshti nr.5 "Xixëllonjat"	Lagjja nr.1	14	0	6	1	15
Kopshti nr.6 "Elfët"	Lagjja nr.1	7	0	3	0	4
Kopshti nr.7 "Cicërimat"	Lagjja nr.1	4	0	1	0	0
Kopshti nr.8 "Luledielli"	Lagjja nr.1	6	0	2	0	8
Kopshti nr.1 "Dallandyshtet"	Lagjja nr.2	9	0	3	1	2
Kopshti nr.2 "Kolopuçët"	Lagjja nr.2	4	0	1	0	0
Kopshti nr.3 "Mjellmat"	Lagjja nr.2	3	0	1	0	0
Kopshti nr.12 "Topolino"	Lagjja nr.2	12	0	4	0	12
Kopshti nr.14 "Zarife Hasani"	Paskuqan	10	0	5	1	11
Kopshti nr.15 "Borëbardha"	Paskuqan	12	0	4	1	14
Kopshti nr.16 "Çamarrokët"	Paskuqan	5	0	1	0	1

Kopshti nr.17 "Engjëjt"	Paskuqan	11	0	3	1	6
Kopshti nr.18 "Lepurushët"	Paskuqan	3	0	1	0	0
Kopshti nr.19 "1- Qershori"	Paskuqan	9	0	1	0	0

Struktura e burimeve njerëzore në institucionet parashkollore të Bashkisë Kamëz është një tregues i rëndësishëm i angazhimit për ofrimin e një edukimi cilësor dhe gjithëpërfshirës që në fëmijërinë e hershme. Aktualisht, stafi edukativ përbëhet nga **157 edukatore** dhe **11 psikologë** e punonjës socialë, të shpërndarë në mënyrë të balancuar në kopshtet sipas njësive administrative. Ky kapacitet profesional mbështet zhvillimin emocional, social dhe kognitiv të fëmijëve, duke siguruar mbështetje të specializuar edhe për raste që kërkojnë ndjekje më të thelluar.

Në të njëjtën kohë, stafi ndihmës përfshin **70 ndihmëse edukatore, 57 sanitare dhe 34 punonjës të shërbimeve mbështetëse (roje dhe mirëmbajtës)**, edhe pse të gjitha institucionet monitorohen me kamera. Stafi mundëson garantimin e një mjedisi të pastër, të sigurt dhe të mirëorganizuar. Ky konfigurim tregon një shpërndarje funksionale të burimeve njerëzore, që mbështet misionin edukativ të kopshteve dhe ndihmon në krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e fëmijëve.

Bashkia Kamëz e konsideron investimin në stafin e kopshteve si një element thelbësor për cilësinë e shërbimit arsimor parashkollor dhe është e angazhuar në fuqizimin e mëtejshëm të këtij rrjeti profesional në vitet e ardhshme.

5. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative

Njësia Administrative: Paskuqan

Shkollat

Në njësinë administrative paskuqan, funksionojnë 7 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 1 shkolla janë në ciklin fillor, ndërsa 6 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 0 janë shkolla të mesme që u japin të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë apo për të hyrë në tregun e punës me përgatitje profesionale.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës.



Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkolles
Shkolla 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit"
Shkolla 9-vjeçare "Jashar Hoxha"
Shkolla 9-vjeçare "Azem Hajdari" Paskuqan
Shkolla 9-vjeçare "Tahir Sinani"
Shkolla 9-vjeçare "Dom Nikollë Kaçorri"
Shkolla 9-vjeçare "Vllazërimi"
Gjimnazi "Isa Boletini"
Gjimnazi "Gramoz Palushi"

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 6 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
Kopshti nr.14 "Zarife Hasani"
Kopshti nr.15 "Borëbardha"
Kopshti nr.16 "Çamarrokët"
Kopshti nr.17 "Engjëjt"
Kopshti nr.18 "Lepurushët"
Kopshti nr.19 "1- Qershori"

Njësia Administrative: Lagja Bathore

Shkollat

Në këtë njësi funksionojnë 3 shkolla, shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit,

Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkolles
“Ibrahim Basha”
“Halit Coka”
“Ahmet Zogu”

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 5 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
Kopshti nr.9 "Bota e Luleve"
Kopshti nr.10 "Lulet e Jetës"
Kopshti nr.11 "Kësulëkuqja"
Kopshti nr.13 "Gjeniu i vogël"
Kopshti nr.20 "Lule Bore"

Njësia Administrative: Lagjja Nr. 1

Shkollat

Në total, funksionojnë 5 shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit.

Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkollës
“Kamza e Re”
“Niko Hoxha”
“Demokracia”
“Nënë Tereza”
“Dom Nikollë Kaçorri”

Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësise janë të hapura gjithsej 5 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
Kopshti nr.4 "Bletëzat"
Kopshti nr.5 "Xixëllonjat"
Kopshti nr.6 "Elfët"
Kopshti nr.7 "Cicërimat"
Kopshti nr.8 "Luledielli"

Njësia Administrative: Lagjja nr.2

Shkollat

Në total, funksionojnë 6 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto 4 janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, 1 shkollë e mesme dhe 1 shkollë e mesme profesionale.



Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkollës
"Hillary Clinton"
"Fatos Lami"
"100 Vjetori"
"Arberia"
"Elina"

Kopshtet

Në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 4 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
Kopshti nr.1 "Dallandyshtet"
Kopshti nr.2 "Kolopuçët"
Kopshti nr.3 "Mjellmat"
Kopshti nr.12 "Topolino"

6. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversita

Vizioni

“Të ndërtojmë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, cilësor dhe të aksesueshëm për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Kamëz – ku çdo institucion edukativ të jetë një hapësirë e sigurt, e pajisur, e përkushtuar dhe e lidhur ngushtë me komunitetin.”



Shtyllat udhëheqëse të vizionit:

1. Përfshirje dhe barazi:

- Asnjë fëmijë jashtë sistemit arsimor, me fokus të veçantë tek fëmijët e moshës 3–6 vjeç dhe grupet në nevojë.
- Politika për barazi gjinore, përfshirje të komuniteteve rome dhe egjiptiane, dhe mbështetje për fëmijët me aftësi ndryshe.

2. Cilësi dhe zhvillim profesional:

- Rritja e standardeve të mësimdhënies dhe zhvillimit profesional të stafit edukativ dhe ndihmës.
- Përmirësimi i metodologjive të të nxënësve përmes qasjes aktive, bashkëpunuese dhe të orientuar drejt të ardhmes.

3. Infrastrukturë dhe mjedis edukues:

- Rikonstruktimi dhe zgjerimi i kopshteve dhe shkollave për të garantuar mjedise të sigurta, të pastra dhe funksionale.
- Pajisje bashkëkohore didaktike dhe digjitale në çdo institucion.

4. Zhvillim i hershëm dhe kujdes parashkollor:

- Investim në arsimin e hershëm për fëmijët 0–6 vjeç si themel i suksesit në edukimin e mëtejshëm.
- Rritje e kapacitetit të kopshteve publike dhe partneritete me sektorin privat.

5. Bashkëpunim me prindërit dhe komunitetin:

- Fuqizimi i rolit të prindërve në procesin edukativ përmes forumeve, trajnimeve dhe këshillave të kopshtit/shkollës.
- Nxitja e ndjenjës së përkatësisë dhe kujdesit të përbashkët për institucionet arsimore.

Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve

✓ Qëllimi 1: Sigurimi i një mjedisi të sigurt, funksional dhe të aksesueshëm për çdo fëmijë në institucionet arsimore dhe parashkollore të Bashkisë Kamzë

Bashkia Kamzë synon të përmirësojë infrastrukturën arsimore në territorin e saj, në përputhje me normat bashkëkohore të sigurisë, higjienës dhe gjithëpërfshirjes, duke vënë në qendër nevojat reale të fëmijëve dhe komuniteteve të ndryshme.

Objektivat:

- **Objektivi specifik O1.1:** Të garantohet funksionimi i përditshëm i institucioneve arsimore përmes sigurimit të kushteve bazë: mirëmbajtje e rregullt, ngrohje, ujë të pijshëm, ushqim, higjienë, transport dhe kancelari, veçanërisht në kopshtet me shërbim ditor.
- **Objektivi specifik O1.2:** Të kryhen investime të orientuara në rikonstruksionin e kopshteve, zgjerimin e kapaciteteve në zonat me mbingarkesë, dhe instalimin e sistemeve të informacionit për menaxhimin dhe transparencën institucionale.

✓ Qëllimi 2: Zhvillimi gjithëpërfshirës i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar

Duke u bazuar në të dhënat Bashkia Kamzë angazhohet të rrisë përfshirjen, të fuqizojë cilësinë e edukimit dhe të mbështesë çdo fëmijë, veçanërisht ata në rrezik social ose me aftësi ndryshe.

Objektivat:

- **Objektivi specifik O2.1:** Të forcohet cilësia e edukimit në kopshtet ekzistuese përmes trajnimeve të rregullta për edukatorët dhe përdorimit të mjeteve didaktike bashkëkohore.
- **Objektivi specifik O2.2:** Të zgjerohet oferta e shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta, përmes punësimit të mësuesve ndihmës dhe specialistëve të mbështetjes psiko-sociale.
- **Objektivi specifik O2.3:** Të krijohen dhe fuqizohen mekanizma të bashkëpunimit shkollë–familje–komunitet për të rritur ndërgjegjësimin prindëror dhe për të forcuar ndjenjën e përfshirjes në procesin edukativ.

✓ Qëllimi 3: Nxitja e talenteve, përfshirjes kulturore dhe ndjesisë së përkatësisë përmes aktiviteteve edukative jashtëkurrikulare

Në një qytet me rritje të shpejtë demografike dhe diversitet social, është e rëndësishme të krijohen hapësira që forcojnë identitetin, kreativitetin dhe lidhjen komunitare të fëmijëve në Kamzë.

Objektivat:

- **Objektivi specifik O3.1:** Të organizohen rregullisht aktivitete kulturore, sportive, mjedisore dhe sociale në kopshtet dhe shkollat fillore për të nxitur zhvillimin emocional, bashkëpunimin dhe talentet e fëmijëve.
- **Objektivi specifik O3.2:** Të ndërtohen partneritete me qendrat rinore, qendrat komunitare, organizatat e artit dhe sportit për të diversifikuar ofertën edukative dhe për të integruar institucionet arsimore me jetën komunitare.

Përmbledhje e investimeve kapitale (2026–2028)

Në kuadër të përmirësimit të kushteve të edukimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të infrastrukturës arsimore në territorin e Bashkisë Kamzë, janë planifikuar një sërë **investimesh kapitale** që përfshijnë si rindërtime, ashtu edhe ndërtime të reja në institucione arsimore dhe parashkollore. Këto projekte synojnë rritjen e cilësisë së shërbimeve arsimore dhe aksesin më të gjerë për komunitetin.

Projektet kryesore të planifikuara:

1. **Rindërtimi i kopshtit "Lepurushet"**
 - Objektivi: Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese, për të siguruar një ambient të sigurt, funksional dhe të përshtatshëm për zhvillimin e fëmijëve të moshës parashkollore.
 - Përfitues: Familjet me fëmijë në zonën përkatëse dhe stafi edukativ.
2. **Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Dom Nikoll Kaçorri", Paskuqan**
 - Objektivi: Zëvendësimi i godinës ekzistuese me një strukturë moderne që përmbush standardet bashkëkohore të mësimdhënies.
 - Përmirësim në sigurinë, kapacitetin dhe cilësinë e mësimin për nxënësit e ciklit fillor dhe të mesëm të ulët.

3. Ndërtimi i fushave sportive në shkollën "100 Vjetori", Kamëz

- Objektivi: Zhvillimi i infrastrukturës sportive si pjesë e edukimit gjithëpërfshirës dhe shëndetit fizik të nxënësve.
- Ndihmon në promovimin e aktivitetit fizik dhe përdorimin efikas të hapësirave shkollore.

4. Ndërtimi i shkollës së mesme "Sulejman Elezi", Laknas

- Objektivi: Krijimi i një institucioni të ri arsimor për ciklin e mesëm të lartë në zonën e Laknasit, për të përballuar rritjen e popullsisë dhe nevojën për arsim cilësor.
- Përmirësim i aksesit në arsim të mesëm për të rinjtë në zonat periferike.

5. Ndërtimi i një kopshti të ri me ushqim në qendër të Kamzës

- Objektivi: Zgjerimi i rrjetit të institucioneve parashkollore në zonën qendrore të qytetit, me kushte bashkëkohore dhe ofrim të shërbimit të ushqimit për fëmijët.
- Rritja e mbulimit dhe përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor.

Qëllimi i përgjithshëm i investimeve:

Të garantohet një **rritje e cilësisë dhe e aksesit në arsimin parauniversitar**, përmes krijimit të infrastrukturës moderne, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, duke përbushur nevojat aktuale dhe afatgjata të komunitetit të Bashkisë Kamëz.

7. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar

Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parauniversitar

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve nga grupe vulnerabël.
- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;
- Arsimi profesional përfshin ofrimin e shërbimet për nxënësit e arsimit profesional që frekuentojnë dhe konviktet;

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore. Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar financimin buxhetor të shërbimit të arsimit parauniversitar, mënyrën e plaifikuar të përdorimit të fondeve publike për arsimin parauniversitar, si dhe për të identifikuar boshllëqet ose mundësitë për investime të reja në funksion të përmirësimit të cilësisë së edukimit

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Për periudhën 2026–2028, buxheti total i planifikuar për arsimin bazë përfshirë arsimin parashkollor është 1,361,941,681.45 lekë, të shpërndara si më poshtë:

Viti 2026

Totali i planifikuar për vitin 2026 është 454,150,063 lekë i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi i llogarise	Aktiviteti	Viti 2026 në Lekë
600	Paga dhe te tjera shpenzime personeli	288,990,453
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	47,303,953
602	Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime	76,361,921
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	1,610,630
231	Shpenzime per rritjen a aktiveve te qendrueshme te trupezuara	23,667,046
231	Shpenzime per rritjen a aktiveve te qendrueshme te trupezuara	2,000,000
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	7,426,300
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	1,591,350
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	4,774,050
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	424,360

Viti 2027

Totali i planifikuar për vitin 2027 është 447,187,990 lekë i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi i llogarise	Aktiviteti	Viti 2027 në Lekë
600	Paga dhe te tjera shpenzime personeli	294,017,801
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	48,098,892
602	Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime	82,647,915
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	1,626,736
231	Shpenzime per rritjen a aktiveve te qendrueshme te trupezuara	5,154,103
231	Shpenzime per rritjen a aktiveve te qendrueshme te trupezuara	1,000,000
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	7,649,089
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	1,639,091
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	4,917,272
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	437,091

Viti 2028

Totali i planifikuar për vitin 2028 është 460,603,628.45 Lekë i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi i llogarise	Aktiviteti	Viti 2028 në Lekë
600	Paga dhe te tjera shpenzime personeli	302,838,334.77
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	49,541,858.47
602	Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime	85,127,351.98
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	1,675,538.39
231	Shpenzime per rritjen a aktiveve te qendrueshme te trupezuara	5,308,725.95
231	Shpenzime per rritjen a aktiveve te qendrueshme te trupezuara	1,030,000.00
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	7,878,561.67
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	1,688,263.22
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	5,064,790.00
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individed	450,204.00

Shpenzimet parashikohen të kontribuojnë në forcimin e një sistemi parashkollor gjithëpërfshirës, të aksesueshëm dhe të orientuar drejt cilësisë.

Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm

Për arsimin e mesëm të përgjithshëm, investimet kanë mundësuar modernizimin e infrastrukturës arsimore, pajisjen me mjete didaktike dhe teknologjike, si dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit mësimor dhe drejtuesve shkollorë. Këto ndërhyrje kanë si qëllim krijimin e kushteve të barabarta mësimore për të gjithë nxënësit dhe përmirësimin e performancës akademike në të gjithë territorin e bashkisë.

Buxheti i përgjithshëm i planifikuar për këtë sektor për vitet 2026–2028 arrin në 85,081,000 lekë, të shpërndara si më poshtë:

Viti 2026

Totali i planifikuar për vitin 2026 është 27,137,781 Lekë ,i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi i llogarise	Aktiviteti	Viti 2026 në Lekë
600	Paga dhe shpenzime personeli	11,516,511
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,977,890
602	Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime	8,444,970

Viti 2027

Totali i planifikuar për vitin 2027 është 28,543,458 Lekë i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi i llogarise	Aktiviteti	Viti 2027 në Lekë
600	Paga dhe shpenzime personeli	11,644,278
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	2,006,018
602	Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime	9,538,799

Viti 2028

Totali i planifikuar për vitin 2028 është 29,399,761 Lekë i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi 0i llogarise	Aktiviteti	Viti 2028 në Lekë
600	Paga dhe shpenzime personeli	11,993,606
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	2,066,198
602	Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime	9,824,963

Këto fonde janë të orientuara drejt ndërtimit të një mjedisi mësimor gjithëpërfshirës dhe efektiv, duke kontribuar njëkohësisht në reduktimin e braktisjes shkollore dhe forcimin e lidhjes midis arsimit dhe zhvillimit lokal.

8. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

Qëllimi 1 (Q1) Sigurimi i një mjedisi të sigurt, funksional dhe të aksesueshëm për çdo fëmijë në institucionet arsimore dhe parashkollore të Bashkisë Kamëz

Objektivi specifik O1. Të garantohet funksionimi i përditshëm i institucioneve arsimore përmes sigurimit të kushteve bazë: personeli i nevojshëm, mirëmbajtje e rregullt, ngrohje, ujë të pijshëm, ushqim, higjienë, transport dhe kancelari.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Mbështetja me pagesë dhe sigurime shoqërore për personelin arsimor - Sigurimi i fondeve për pagat dhe kontributet shoqërore e shëndetësore për punonjësit e arsimit parashkollor, bazë dhe të mesëm nën administrimin e bashkisë.	2026–2028	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit	Këshilli Bashkiak	Transferte specifike + Buxhet vendor Perfshire ne zerin “ <i>Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli</i> ” dhe “ <i>Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore</i> ”	Nr. i punonjësve të mbështetur financiarisht; Nr. i fëmijëve të regjistruar në kopësht (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) që përfitojnë shërbimi i arsimit parashkollor
Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore - Zbatimi i ndërhyrjeve mirëmbajtjes të planifikuara dhe emergjente për ruajtjen e funksionalitetit dhe sigurisë së ambienteve shkollore dhe parashkollore.	2026–2028	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Drejtoria e investimeve;	Shkollat, kopshtet	Buxhet vendor + transferte e pakushtëzuar specifike Perfshire ne zerin “ <i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime</i> ”	Nr. ndërhyrjeve të realizuara në godina (Lyerje, ndarje ambientesh, mirëmbajtje kaldajash, elektroshtepiakesh, kompjuterash, printerash, pajisjesh të zyrave)

Garantimi i kushteve higjeno-sanitare në institucionet arsimore - Sigurimi i pastrimit të përditshëm dhe përmirësimi i standardeve të higjienës për mjedise të shëndetshme dhe të sigurta për fëmijët, nxënësit dhe stafin.	2026–2028	Drejtorja e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	Shkollat, operatorë të higjienës , kopshtet	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin “ <i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime</i> ”	Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare
Sigurimi i sistemeve funksionale të ngrohjes në institucionet arsimore - Instalimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të ngrohjes për të garantuar kushte komode në periudha të ftohta.	2026–2028	Drejtorja e Arsimit, Rinisë dhe Sportit Ndërmarrja e Shërbimeve publike	Operator të energjisë ,	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin “ <i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime</i> ”	Nr. i institucioneve me sistem funksional ngrohjeje
Furnizimi i institucioneve arsimore me materiale kancelarie - Pajisja e rregullt e kopshteve dhe shkollave me mjete të domosdoshme për administrim, mësimdhënie dhe menaxhim të brendshëm.	2026–2028	Drejtorja e Arsimit, Rinisë dhe Sportit	Shkollat	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin “ <i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime</i> ”	Nr. i institucioneve të furnizuara me kancelari
Furnizimi, kontrolli teknik dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit Garantimi i kushteve të sigurisë kundër zjarrit përmes mirëmbajtjes së	2026–2028	Drejtorja e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	Zjarrfikë sja, NjA	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin “ <i>Shpenzime</i>	Nr. i fikseve të vendosura dhe funksionale

mjeteve të ndërhyrjes emergjente.				Korrente, Mallra dhe sherbime”1	
Furnizimi me dokumentacion administrativ për nevojat institucionale Prokurimi i regjistrave, formularëve dhe dokumenteve të tjera që mbështesin funksionimin administrativ të shkollave dhe kopshteve.	2026–2028	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit	Shkollat	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin “Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime”	Nr. i shkollave të pajisura me dokumentacion
Pajisja e institucioneve arsimore me mjete didaktike bashkëkohore - Mbështetja e procesit mësimor me mjete dhe materiale që ndihmojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësive të nxënësve.	2026–2028	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit ZVAK	Kopshtet MAS	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin “Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime” Donacione, prindërit	Nr. i institucioneve të pajisura me mjete didaktike dhe materiale që ndihmojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësive të nxënësve.
Furnizimi Ofrimi i shërbimit ushqimor për fëmijët në institucionet parashkollore - Sigurimi i vakteve ditore të shëndetshme dhe të balancuara për fëmijët që ndjekin kopshtet publike.dhe shërbimi ushqimor në institucionet e arsimit parashkollor	2026–2028	Zyra Shëndetit Publik, Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, ZVAK	Operatorët e licencuar , Ministria e Arsimit, Sportit (MAS)	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin “Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime”	Nr. i mensave funksionale në kopshte

Zbatimi i shërbimeve të dezinfektimit në institucionet arsimore - Kryerja periodike e dezinfektimeve për garantimin e sigurisë shëndetësore në përputhje me udhëzimet higjieno-sanitare.	2026–2028	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), operatorë të kontraktuar	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin “ <i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime</i> ”+ fond emergjence	Nr. i dezinfektimeve të kryera në vit, rendi periodik I kryerjes së dezinfektimieve dhe pajisja me çertifikatën përkatëse për çdo institucion arsimor
Ofrimi i transportit mbështetës për funksionimin e institucioneve arsimore bashkiake - Sigurimi i mjeteve të transportit për nevojat logjistike dhe operacionale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e bashkisë.	Çdo vit	ZVAK	Drejtoria e Transporteve, administrata	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin sherbim transporti ne “ <i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime</i> ”	Shpenzime për karburant, siguracione, pjesë këmbimi për 3 automjete të shërbimit të DA, dhe udhëtime për administratën

Objektivi specifik O1.2 Të kryhen investime të orientuara në rikonstruksionin e kopshteve, zgjerimin e kapaciteteve në zonat me mbingarkesë, dhe instalimin e sistemeve të informacionit për menaxhimin dhe transparencën institucionale.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit bazë: Rikonstruksion i shkollave të arsimit bazë 1. Rikonstruksioni I Shkollës 9-vjeçare “Dom Nikoll Kaçorri” Paskuqan	Çdo vit 2026–2028	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Investimeve	Qeveria shqiptare Bashkia,	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike	Nr. i institucioneve të arsimit bazë të rikonstruktura; Përmirësim i kushteve
Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit parashkollor: Rikonstruksion I Kopshteve 1. Rikonstruksion I kopshtit të integruar Brenda shkollës Kopshti Nr. “Lepurushët”, Paskuqan 2. Ndërtimi i kopshtit të ri me ushqim, Qendër Kamëz		Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e investimeve	Qeveria shqiptare Bashkia,	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike	Nr. i institucioneve arsimore parashkollorë të rikonstruktura dhe të ndërtuara; Përmirësim i kushteve
Investime për pajisje në godinat e shkollave të arsimit të mesëm të përgjithshëm. 1. Ndërtimi i Shkollës së mesme “Sulejman Elezi” Laknas		Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e investimeve		Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike	Nr. i institucioneve arsimore të ndërtuara
Ndërtim i një sistemi të dhënash digjitale për kopshtet dhe shkollat në kuadër të planit për përmirësim të arsimit parauniversitar:	2026–2028	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit,	Kopshtet/s hkollat; Ekspertë të jashtëm	Buxheti i Bashkisë (orë pune punonjës të angazhuar në punë), përfshirë në zerin “Paga Shperblime dhe te tjera	Një regjistër i shërbimit për arsimin parashkollor, arsimin baze dhe atë të mesëm i krijuar, dhe i përditësuar çdo vit me të dhëna

Qëllimi 2 (Q2) – Zhvillimi gjithëpërfshirës i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar

Objektivi specifik O2.1 Të forcohet cilësia e edukimit në kopshtet ekzistuese përmes trajnimeve të rregullta për edukatorët dhe përdorimit të mjeteve didaktike bashkëkohore

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Pajisje me materiale didaktike, kompjuterë dhe trajnime për edukatorët	Çdo vit	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit,	MAS, partnerë zhvillimi	Buxhet vendor + transfertën e pakushtëzuar specifike përfshirë në zërin “Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli” dhe “Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore” Organizara partnere të tjera	Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) që përfitojnë nga mjetet dhe trajnimet
Fuqizimi i kapaciteteve të stafit arsimor të institucioneve parashkollore, në funksion të garantimit të një edukimi cilësor dhe mbështetës për zhvillimin e hershëm të fëmijëve.	2026–2028	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit,	MASR, institucionet arsimore, OSHC, ASKAP0000 0000000	Buxhet vendor + transfertën e pakushtëzuar specifike përfshirë në zërin “Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli” dhe “Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore”	Nr. i edukatorëve të trajnuara; përmirësimi i praktikave të mësimdhënies;

Objektivi specifik O2.2 Të zgjerohet oferta e shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta, përmes punësimit të mësuesve ndihmës dhe specialistëve të mbështetjes psiko-sociale.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopshte	2026–2028	Drejtorja e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Drejtorja e Burimeve Njerëzore	OJQ sociale, MAS	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike përfshirë në zërin “ <i>Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli</i> ” dhe “ <i>Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore</i> ”	Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) me ndihmë sociale;
Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat.	2026–2028	Drejtorja e Arsimit, Rinisë dhe Sportit	Administratorët e Njërive Administrative; këshilli bashkiak; Kopshtet; Prindërit	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Struktura menaxhuese në kopshte dhe shkolla aktive Pjesëmarrja e balancuar gjinore e prindërve (nënë/baba) në strukturat menaxhuese të kopshteve dhe shkollave
Ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte	2026–2028	Drejtorja e Arsimit, Rinisë dhe Sportit,	Kopshtet; OSHC	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) të mbështetur me shërbim psiko social

		Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social			
Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë	2026–2028	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ	Buxhet vendor + donacione + projekte sociale	Nr. i nxënësve (vajza/djem) nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel të mbështetur
Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera	2026–2028	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	MAS, mësues, komuniteti	Buxhet vendor + shpërblime nga MAS	Nr. i nxënësve (vajza/djem) me rezultate të shkëlqyera të mbështetur

Objektivi specifik O2.3 Të krijohen dhe fuqizohen mekanizma të bashkëpunimit shkollë–familje–komunitet për të rritur ndërgjegjësimin prindëror dhe për të forcuar ndjenjën e përfshirjes në procesin edukativ.

Aktivitete	Periodha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Organizimi i fushatave informuese dhe edukative për prindërit dhe kujdestarët, veçanërisht në lagje dhe fshatra me mungesë informacioni mbi	Tremujori I–II 2026, 2027, 2028	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit	Drejtoria e Shëndetësisë, OJF lokale, Këshillat e Prindërve	Zëri 602 – Mallra dhe shërbime; Donatorë lokalë OSHC	- Numri i fushatave të realizuara - Numri i prindërve të informuar - Rritje e regjistrimeve në kopsht në zonat target

rëndësinë e edukimit të hershëm.					
Zhvillimi i bashkëpunimit me punonjësit socialë dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës për të identifikuar fëmijët që nuk ndjekin kopshtin për shkak të kushteve ekonomike, kulturore ose sociale, dhe për të ofruar mbështetje të përshtatur. Këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat.	Tremujori II–III 2026, 2027, 2028	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit	Qendrat Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, OJF	Zëri 602 dhe 606 – Trajnime dhe koordinim; Projekte të mbështetura	- Numri i fëmijëve të identifikuar - Numri i fëmijëve të përfshirë në shërbim pas ndërhyrjes - Raste të trajtuara përmes planit të mbështetjes
Nxitja e përfshirjes së këshillave të prindërve dhe organizatave komunitare lokale në proceset vendimmarrëse, planifikuese dhe monitoruese të shërbimit arsimor, me qëllim rritjen e transparencës dhe bashkëpronësisë	Tremujori I–IV 2026, 2027, 2028 (proces i vazhdueshëm)	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit	Bordi i Shkollës, Bordi i kopshtit, Këshillat e Prindërve, Komuniteti lokal	Zëri 600 dhe 606 – Orë pune, mbledhje dhe aktivitete komunitare	- Numri i këshillave funksionale - Frekuentimi i takimeve - Propozime të komunitetit të reflektuara në vendimmarrje

Qëllimi 3 (Q3)– Nxitja e talenteve, përfshirjes kulturore dhe ndjesisë së përkatësisë përmes aktiviteteve edukative jashtëkurrikulare

Objektivi specifik O3.1 Të organizohen rregullisht aktivitete kulturore, sportive, mjedisore dhe sociale në kopshtet dhe shkollat fillore për të nxitur zhvillimin emocional, bashkëpunimin dhe talentet e fëmijëve.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
------------	---------------------	------------	----------	--------------------	---------

Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit:	Çdo vit	Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse;
1. 23–30 Shtator – Java Evropiane e Sportit  Loja sportive në oborrin e kopshtit (loja popullore)  Ushtrime në natyrë (gimnastikë)  Loja të ndryshme lëvizore, Gara me biçikleta, etj.)		Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse;
2. Prill–Maj – Java Olimpikë  Loja të ndryshme sportive (stafeta me flamuj, topa)  Gara vrapimi, midis kopshteve në grupe  Gara me biçikleta		Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse;
3. 20 Nëntor – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve  Bisedë, postera, aktivitete në natyrë (Kam të drejtë të luaj)  Ekspozitë me materiale të përgatitura nga fëmijët “Të drejtat e mia”  "Unë mbroj të drejtat e mia" (bisedë)		Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse;
4. Dita e Luftës Kundër Bullizmit (21 nëntor)  Bisedë me fëmijët		Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse;
1. Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe  Postera me gjuhën shqipe & ilustrime  Koncert për gjuhën shqipe (Gjuha jonë sa e mirë)		Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse;
2. Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (3 dhjetor)  Biseda sensibilizuese për fëmijët me nevoja të veçanta  Loja me role (si t'i ndihmojmë shokët me nevoja të veçanta)  Ekspozitë me punime të përgatitura nga fëmijët me AK		Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse;

3. Dita Botërore e Gjuhës Amtare ✚ Vizitë në bibliotekë	Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet mbështetje donatorësh	vendor,	Numër dhe larmi aktivitetesh; gjithëpërfshirëse;
4. Dita Botërore e Ujit (UNESCO 22 mars) ✚ Rëndësia dhe vlerat e ujit (bisedë, prezantime) ✚ “Uji është jetë” (Postera, eksperiment me ujëra) ✚ Bisedë për vlerat e ujit	Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet mbështetje donatorësh	vendor,	Numër dhe larmi aktivitetesh; gjithëpërfshirëse;
5. Dita Ndërkombëtare e Romëve ✚ Bisedë për fëmijët romë	Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet mbështetje donatorësh	vendor,	Numër dhe larmi aktivitetesh; gjithëpërfshirëse;
6. Zakonet dhe traditat e romëve	Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet mbështetje donatorësh	vendor,	Numër dhe larmi aktivitetesh; gjithëpërfshirëse;
7. Dita Botërore e Librit (23 prill) ✚ Ne dimë të bëjmë libra (aktivitet krijues) ✚ Vizitë në bibliotekë ✚ Dhuro një libër, hap një dritare (fushatë sensibilizuese)	Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet mbështetje donatorësh	vendor,	Numër dhe larmi aktivitetesh; gjithëpërfshirëse;
8. Dita Botërore e Mjedisit (5 qershor) ✚ Ekspozitë me mjete të riciklueshme ✚ Mbrojmë tokën, planetin tonë (projekt) ✚ Mbjellim lule në oborrin e kopshtit ose në vazo (aktivitet praktik) ✚ Mbajmë pastër mjedisin ku mësojmë e luajmë (aktivitet praktik, bisedë) ✚ Ekskursion në lulishten e qytetit	Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet mbështetje donatorësh	vendor,	Numër dhe larmi aktivitetesh; gjithëpërfshirëse;
9. Yjet e Vallzimit ✚ Konkurs midis kopshteve të qytetit	Shkollat /kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet mbështetje donatorësh	vendor,	Numër dhe larmi aktivitetesh; gjithëpërfshirëse;

Objektivi specifik O3.2 Të inkurajohet bashkëpunimi me institucione kulturore, sportive dhe artistike në qytet për të krijuar sinergji dhe mundësi të reja edukative për fëmijët.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit:	Çdo vit	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit ZVAK	Prindër, OJQ	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse
1. Vizita në bibliotekë (për Ditën e Gjuhës Amtare dhe Ditën e Librit)	Shkurt & Prill	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit ZVAK, P “Artan Cuku”	Biblioteka, Bashkia, Drejtoria Rajonale e Kulturës	Buxhet shkollor, mbështetje nga institucionet kulturore	Numri i vizitave në bibliotekë; pjesëmarrja e fëmijëve
2. Ekskursione edukative në muze, galeri, qendra sportive dhe aktivitete komunitare.	Çdo vit	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Institucionet Arsimore	Prindër, OJQ	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse
3. Fushata “Dhuro një libër, hap një dritare” (me bashkëpunimin e institucioneve kulturore)	Prill	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Institucionet Arsimore	Qendra Kulturore, Biblioteka, Prindër	Mbështetje donatorësh, Buxhet vendor	Numri i librave të dhuruar; numri i fëmijëve të përfshirë
4. “Pedalo për turizëm dhe kulturë” – aktivitet në hapësira publike me mbështetjen e institucioneve vendore 🚲 Pedalim me biçikleta në pedonalen e qytetit	Maj–Qershor	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit	Bashkia, Drejtoria e Kulturës,	Bashkia, partnerë lokalë	Numri i fëmijëve pjesëmarrës; numri i punimeve ekspozuar

 Ekspozitë me punime, vizatime dhe postera		dhe Institucionet Arsimore	Policia Bashkiake		
5.	“Pedalo Kuq” – marshim festiv me bashkëpunim ndërsektorial për Festat Kombëtare	Nëntor	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Institucionet Arsimore	Bashkia, Drejtoria e Arsimit, Policia Bashkiake, MAS	Numri i pjesëmarrësve; vlerësim nga prindërit dhe publiku

9. Plani i investimeve kapitale

Lista e projekteve të investimeve për periudhën afatmesme 2026 -2028 (në mijë lekë)

Nr.	Emërtimi i Projektit	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Shuma
1	Të ndryshme arsimit 9-vjeçar	5 000 000	-	-	5 000 000
2	Ndërtim kopshti Babrru Qendër	2 530 000	-	-	2 530 000
3	Ndërtim kopshti Qendër Kamëz	37 465 000	-	-	37 465 000
4	Investime të tjera të periudhës në vazhdim	122 598 000	83 667 000	83 667 000	289 932 000
Shuma		167 593 000	83 667 000	83 667 000	334 927 000

10. Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjikë. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetsesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë:

- Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara;
- Numrin i kopshteve (hapësirave) të reja funksionale;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Eficienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore. Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënës;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- Njësitë e statistikës/performances dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

1. **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
2. **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

- **0** – Aktiviteti nuk ka nisur.
- **1–9** – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.
- **10** – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete x 10 = 50 pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmbledhen në nivel objektiv. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale:

Përqindja e realizimit të objektivit = (Pike të realizuara / Piket maksimale) × 100

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

Vlerësimi i ndikimit në komunitet

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve dhe shkollave të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopsht ose shkollë).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Në rastet kur aktiviteti synon vetëm një kategori (p.sh. vetëm kopshtet), pjesëmarrja për kategorinë tjetër do të konsiderohet.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

Përqindja e pjesëmarrjes = (Numri real i pjesëmarrësve / Numri target) × 100

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

11. Rishikimi dhe përshtatja e planit

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Kamzë. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Procesi i rishikimit

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Planifikohen këto forma rishikimi:

- **Rishikimi vjetor** – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;
- **Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2027)** – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;
- **Rishikime të jashtëzakonshme**, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).

Ky proces do të kryhet në mënyrë të ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

Përshtatja e masave dhe aktiviteteve

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:

- **Aktivitete konkrete** – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit;
- **Alokimin e burimeve** – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat;
- **Prioritetet vjetore** – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal;
- **Metodologjinë e zbatimit** – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.

Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Kamzë.

12. Raportimi dhe transparenca

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparence, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimin të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

13. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar

Kuadri Kushtetues dhe Ligjor i përgjithshëm

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, neni 57, pika 1
- **Ligji Nr. 69/2012**, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me **Ligjin Nr. 48/2018**
- **Ligji Nr. 139/2015**, “Për Vetëqeverisjen 0Vendore”
- **Ligji Nr. 9936/2008**, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 68/2017**, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- **Ligji Nr. 9632/2006**, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- **Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020**, “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- **Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023**, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- **Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018**, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- **Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024**, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit”

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- **Ligji Nr. 121/2016**, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 18/2017**, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025**
- **Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014**, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 658, datë 23.09.2019**, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

Shërbimi psiko-Social dhe përfshirja Sociale

- **Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020**, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- **Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor**, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore

14. Aneks 2: Lista e shkollave

Nr.	Emer	Njësia	Adresa:
1	"Ibrahim Basha"	Bathore	"Ruga e Arbrit", Bathore
2	"Halit Coka"	Bathore	Ruga "Demokracia", Bathore
3	"Ahmet Zogu"	Bathore	Ruga "Erzeni", Bathore
4	"Elez Isuf Ndreu"	Bathore	rruga "Demokracia", Lagje 5, Bathore
5	"Kamzë e re"	Lagjja nr.1	Ruga "Kongresi i Manastirit"
6	"Niko Hoxha"	Lagjja nr.1	Ruga "Thethi", Valias i Vjetër
7	"Demokracia"	Lagjja nr.1	Ruga "Zhvillimi", Valias i Ri
8	"Nënë Tereza"	Lagjja nr.1	Ruga "Skenderbeu", Laknas
9	"Dom Nikollë Kaçorri"	Lagjja nr.1	Ruga "Koka-Kola", Laknas
10	"Hillary Clinton"	Lagjja nr.2	Ruga "Paqesori", Kamzë
11	"Fatos Lami"	Lagjja nr.2	Ruga "Besim Çera", Z.M'ner
12	"100 Vjetori"	Lagjja nr.2	Ruga "Teuta", Kamzë
13	"Arberia"	Lagjja nr.2	Ruga "Azem Hajdari", Kamzë
14	"Ibrahim Rugova"	Lagjja nr.2	Bulevardi "Nënë tereza", Kamzë
15	"Sulejman Elezi"	Lagjja nr.2	Ruga "besim Çera", Zall-Mner
16	"Jashar Hoxha"	Paskuqan	Ruga "Fahri Ramadani", Paskuqan
17	"Azem Hajdari"	Paskuqan	Ruga "Riza Cerova", Paskuqan
18	"Lidhja e Prizerenit"	Paskuqan	Unaza e Madhe , Paskuqan
19	"Tahir Sinani"	Paskuqan	Ruga "Azem Hajdari", Paskuqan
20	"Dom Nikollë Kaçorri"	Paskuqan	Ruga "Konferenca e Mukjes", Babrru
21	"Vllazërimi"	Paskuqan	Ruga "Prengaj", Fushë-Kërçik
22	"Isa Boletini"	Paskuqan	Unaza e Madhe, Paskuqan 1
23	"Gramoz Palushi"	Paskuqan	Ruga "Riza Cerova", Paskuqan

15. Aneks 2: Lista e kopshteve

Nr.	Emer	Njësia	Adresa:
1	Kopshti nr. 9 "Bota e Luleve"	Bathore	Rruga "Demokracia", Bathore
2	Kopshti nr.10 "Lulet e Jetës"	Bathore	Rruga "Gjallica", Bathore
3	Kopshti nr.11 "Kësulëkuqja"	Bathore	Rruga "Co-Plan", Bathore
4	Kopshti nr.13 "Gjeniu i vogël"	Bathore	Rruga "Erzeni", Bathore
5	Kopshti nr.20 "Lule Bore"	Bathore	Rruga "Arbërit"
6	Kopshti nr.4 "Bletëzat"	Lagjja nr.1	Rruga "Kongresi i Manastirit" , Kamzë
7	Kopshti nr.5 "Xixëllonjat"	Lagjja nr.1	Rruga "ASTI", Valias
8	Kopshti nr.6 "Elfët"	Lagjja nr.1	Rruga "Zhvillimi", Valias i Ri
9	Kopshti nr.7 "Cicërimat"	Lagjja nr.1	Rruga "Përparimi"
10	Kopshti nr.8 "Luledielli"	Lagjja nr.1	Rruga "Koka-Kola", Laknas
11	Kopshti nr.1 "Dallandyshtet"	Lagjja nr.2	Rruga "Manhaten" , Kamzë
12	Kopshti nr.2 "Kolopuçët"	Lagjja nr.2	Rruga "Teuta" , Kamzë
13	Kopshti nr.3 "Mjellmat"	Lagjja nr.2	Rruga "Azem Hajdari" , Kamzë
14	Kopshti nr.12 "Topolino"	Lagjja nr.2	Rruga "Besim Çera", Zall - M'ner
15	Kopshti nr.14 "Zarife Hasani"	Paskuqan	Rruga "Fahri Ramadani"
16	Kopshti nr.15 "Borëbardha"	Paskuqan	Rruga "Bule Naipi"
17	Kopshti nr.16 "Çamarrokët"	Paskuqan	Rruga "Mustafa Matohiti"
18	Kopshti nr.17 "Engjëjt"	Paskuqan	Rruga "Riza Cerova"
19	Kopshti nr.18 "Lepurushët"	Paskuqan	Rruga "Betim Muço"
20	Kopshti nr.19 "1- Qershori"	Paskuqan	Rruga "Prengaj"




Shkolla 9-Vjeçare "Dom Nikoll Kaçorri", Laknas




Shkolla 9-Vjeçare “Dom Nikoll Kaçorri”, Laknas




Kopshti Nr.8 “Luledielli”, Laknas




Shkolla 9-Vjeçare “Demokracia” Valias




Shkolla 9-Vjeçare “Demokracia” Valias




Shkolla 9-Vjeçare "Angela Merkel" Kamëz




Shkolla 9-Vjeçare "Angela Merkel" Kamëz



Gjimnazi “Gramoz Palushi” Babrru



Shkolla 9- vjeçare “Azem Hajdari” Babrru



Gjimnazi "Ibrahim Rugova" Kamëz




Gjimnazi "Isa Boletini" Paskuqan




Shkolla 9-vjeçare “Halit Coka” Bathore



Kopshti “Topolino” Zall-Mner



Shkolla 9-Vjeçare “Fatos Lami” Zall-Mner



Kopshti nr.5 “Xixëllonjat”, Valias

Grupi i Punës

Znj. Eralda Çerpia,
Zv. Kryetare e Bashkisë Kamëz;

Znj. Aferdita Zefi, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit Rinisë dhe Sportit, Bashkia Kamëz;

Znj. Rivjana Hoxha, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Bashkinë Kamëz;

Znj. Vjollca Smaçi, Drejtor i Drejtorisë së Financës në Bashkinë Kamëz;

Z. Eni Bistri, Drejtor i Drejtorisë Juridike në Bashkinë Kamëz;

Znj. Dorisa Gjypi, Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Psiko-Social në Bashkinë Kamëz;

Znj. Florilda Dema, Përgjegjëse e Sektorit të Çështjeve ekonomike të Drejtorisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit në Bashkinë Kamëz;

Znj. Silvana Markaj, Specialist i Sektorit të Personelit dhe Juridik pranë Drejtorisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit në Bashkinë Kamëz;

Znj. Elona Karaj, Drejtor i kopshtit nr.5 "Xixëllonjat" në Bashkinë Kamëz;

Znj. Azemika Beqiraj, Drejtor i kopshtit nr.17 "Engjëjt" në Bashkinë Kamëz;

Z. Hysen Koldashi, Drejtor i shkollës 9-vjeçare, "Ahmet Zogu" në Bashkinë Kamëz;

Z. Blerim Deda, Drejtor i gjimnazit "Gramoz Palushi" në Bashkinë Kamëz;

Znj. Arjana Cani, anëtarë e bordit të shkollës "Fatos Lami" në Bashkinë Kamëz;

Znj. Miranda Çota, anëtarë e bordit të gjimnazit "Ibrahim Rugova" në Bashkinë Kamëz;

K R Y E T A R I

Rakip SULI

